



**Aleksandër Arvizu krahason Berishën me Ramiz Alinë: Shqiptarët shpëtuan nga një e keqe e madhe si në '92**

Faqe 7

BOTUES: SOT NEWS

E Mërkurë 21 Gusht 2013

■ Ikin Burgaj dhe Kuliçaj, ja katër kandidatët për kreun e përgjithshëm të policisë

# Reforma në polici, ikin shefat e komisariateve, konkurs për spastrimin e militantëve, rikthehen të larguarit

Faqe 2-3

■ PD gati të zhvendoset në ambientet e Shtëpisë së Ushtrisë, para konstituimit të qeverisë së re



## Bastiset SHQUP-i, Berisha dhe Imami zhvendosin stafin dhe objektet tek Instituti i Projektimeve të Mbrojtjes

Faqe4-5

■ **Juristët: Dekreti i Nishanit për SHQUP i paligjshëm, shkeli nenin 94 të Kushtetutës, të shkarkohet**

Faqe6

■ **SHQUP kalon në duart e Flamur Nokës, vijojnë procedurat për ta kthyer në seli për PD**

Faqe4

■ **Braçe kundërshton Odeta Nishanin: Mos u viktimizo, Nishani do hetohet për korrupsion**

Faqe6

■ **Policia e Nokës rrethon SHQUP për ta boshatisur**

Faqe5

**Qeveria e re nis sot mbledhjen dyditore në Vlorë, ministrat paraqesin stafin dhe programin për 300 ditët e para të qeverisjes**

Ashtu siç edhe ishte paralajmëruar, kryeministri i zgjedhur i shqiptarëve, Edi Rama, do ta mbledhë sot për herë të dytë kabinetin e ri qeveritar në qytetin e Vlorës. Mbledhja...

Faqe 10

**Ilir Meta: PD na vodhi deputetin e Kukësit me kutitë e Lundrës**

Kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta, ka pohuar se partia që ai drejton e ka humbur deputetin e Kukësit në magazinat e Lundrës, të cilat ruheshin nga...

Faqe 7

**Farmacistët kundër pullës fiskale me koncesion, nxit kontrabandën e ilaçeve**

Vendimi i fundit i Ministrisë së Shëndetësisë për barnat dhe shërbimin farmaceutik, i cili vendos rregulla të reja për regjistrimin e tyre nga kompanitë, ka çuar në përplasje mes ministrisë me farmacistët. Dje, ky vendim...

Faqe 11



### Këshilltarët bashkiakë të majtë, akuza Florenc Hoxhës për korrupsion me ndërtime pa leje

Këshilltarët e majtë në Bashkinë e Tiranës akuzojnë kreun e Inspektoratit Ndërtimor, Florenc Hoxha se ka ushtruar korrupsion gjatë detyrës për prishjen e ndërtimeve pa leje. Gjatë një prononcimi për gazetën...

Faqe 12

### OPINION

Faqe 14-15

Nga Besi BEKTESHI

**Provincializmi "ndoshta", që gërryen kryeqendrën e veriut**

Preng Cub LLESHI\*

**Nuk mund të rrëzohet standardi me pallavra politike!**

**Pëmbarrimi u rimerr priftërinjve Pallatin e Kulturës, vazhdon përleshja për kishën në Përmet**

**Shashka e Kishës së Përmetit lojë e Berishës, Janullatosit, Agimit të Artë dhe Spiro Kserës për mbulimin e skandaleve**

Lufta mes Bashkisë së Përmetit dhe klerikëve për Pallatin e Kulturës së Përmetit, duket se nuk është gjë tjetër veçse një sajim dhe shashkë e Sali Berishës për të shpërqendruar vëmendjen nga skandalet e tij të fundit, para largimit...

Faqe 8-9



**Albsig** SHOQËRI SIGURIMESH | JU KTHEN BUZËQESHJEN!  
www.albsig.com.al

# kulture

TKF gëzon statusin kombëtar, kërkohet ndryshimi i organizimit

## MARILDA FURXHI

# Teatri Kombëtar i Fëmijëve, pa menaxher, buxhet dhe prapavijë

Nga Julia VRAPI

Teatri Kombëtar i Fëmijëve është i vetmi institucion teatror që e përfundon sezonin artistik disa javë pas teatrove për të rritur, por dhe fillon më shpejt se të tjerët me aktivitet në shtator. Publiku nuk mungon në këtë institucion teatror, që ndjek shfaqjet e repertorit dhe premierat që arrijnë të vihen në skenë me buxhetin që i akordohet këtij institucioni, dhe që është jo pak problematik. TKF është një institucion, i cili daton prej disa dekadash në jetën artistike të vendit, por përballë punës që bëjnë drejtues dhe aktorë të këtij institucioni, problemet me buxhetin apo dhe mungesa e një menaxheri arti sjellin jo pak probleme në aktivitetin e teatrit. Aktorja Marilda Furxhi prej më shumë se tre dekadash ka dhënë një kontribut të madh në skenën e këtij teatri, dhe sot është një nga aktoret më të vlerësuara të tij, dhe që e njeh shumë mirë problemin e institucionit. Në kohën kur pak javë na ndajnë nga fillimi i sezonit artistik, që nis në shtator, aktorja Furxhi pohon se TKF është

kombëtar dhe politikat kombëtare të tij duhet të kenë pritet edhe lëvizjen e trupës në rrethe me shfaqje, duke theksuar se prej vitesh institucionin vuan dhe mungesën e një menaxheri arti. "Në Teatrin Kombëtar të Fëmijëve duhet të ndryshojë organizimi. Të kemi në organikë një menaxher, i cili është shumë i domosdoshëm në institucion. Duhet të jetë një person i caktuar që të merret me organizimin e shfaqjeve dhe me marrëdhëniet me publikun. Deri më tani për këtë është munduar drejtoresha e teatrit, por për këtë punë duhet të jetë një person kompetent. Ai duhet të merret me organizimin, reklamën, menaxhimin e shfaqjeve, me marrëdhëniet të brendshme dhe të jashtme të teatrit. Mungesën e një specialisti të tillë institucioni e ka vuajtur ndër vite. Për deri sa ne kemi trupë qendrore kombëtare duhet të jetë patjetër dhe një menaxher arti", pohon aktorja Marilda Furxhi. Më tej ajo shton se TKF mbulon politikat e MTKRS për fëmijët, që nga Vermoshi deri në Konispol, por sot fatkeqësisht trupa e aktorëve nuk lëviz dot në

Shqipëri. TKF është institucion kombëtar, vijon më tej aktorja, dhe duhet të ketë fonde dhe për të lëvizur trupa. "Trupa e aktorëve të TKF ka qenë deri në një festival në Pogradec dhe asgjë më shumë. Atëherë cilat janë politikat kombëtare të MTKRS? Vërtetë kjo kërkon më shumë fonde, por ama nëse ne do të kishim një menaxher ai do të menaxhonte dhe të ardhurat monetare. 27 teatro në rrethe janë mbyllur të gjithë, janë vetëm mbi bazë amatore. Teatri i fëmijëve që nga Shkodra deri në Gjirokastrë lëvrohet mbi baza amatore, dhe ne si TKF jemi i vetmi institucion profesionist, por nuk lëvizim me shfaqje. Atëherë kush do ta mbulojë gjithë këtë territor. Kjo gjë duhet të jetë si prioritet në fillim të drejtorit të Qendrës Kulturore dhe politikat e MTKRS duhet ta shikojmë me vëmendje këtë", pohon aktorja. Me një karrierë prej më shumë se tre dekadash në skenën e TKF, aktorja Marilda Furxhi shprehet se sot institucioni ka 11 aktorë, por vuan dhe mungesën e prapavijës. "Në TKF janë gjithsej 11 aktorë, janë shumë sepse kemi



Në Teatrin Kombëtar të Fëmijëve duhet të ndryshojë organizimi. Të kemi në organikë një menaxher, i cili është shumë i domosdoshëm në institucion. Duhet të jetë një person i caktuar që të merret me organizimin e shfaqjeve dhe me marrëdhëniet me publikun...

mangësi të prapavijës, e cila me 3 persona nuk i përgjigjet dot aktorëve. Kemi vetëm një piktor skene, një teknik të fonisë dhe një piktor ekzekutues", tregon aktorja. **Sezoni artistik që nis në shtator**  
Sezoni artistik i TKF ka pasur disa premiera, të cilat do të vijojnë dhe në vijim, por dhe shfaqjet e repertorit sipas aktores Marilda Furxhi kanë bërë që fëmijët të mbushin sallën e teatrit. "Në datën 1 shtator ne fillojmë sezonin e ri artistik dhe në fundjavën e parë ne fillojmë aktivitetin me shfaqje. Ne si TKF e fillojmë më herët nga institucionet e tjera sezonin artistik dhe e mbyllim më vonë se të tjerët, kjo sepse ne e kemi spektatorin e garantuar. Gjatë

sezonit që lamë pas ne kemi pasur dy premiera të reja, "Dhelpra dhe rrushtë" dhe "Kush është hajduti". Ka javë që japim dhe 4 shfaqje në skenë dhe muaji qershor ka qenë me më shumë shfaqje. Në vijim të sezonit do të kemi dhe dy premiera të tjera, njëra do të jetë në skenë me regji të bullgarit Bonjo Lungov", tregon aktorja Marilda Furxhi, e cila për dekada me radhë ka sjellë në skenë me dhjetëra personazhe. E ndërsa TKF ka pasur një jetë që sipas aktorëve vlerësohet jo pak mes shfaqjeve të repertorit që kanë ardhur në skenë e tij përmendim "Kacamisri kërkon shokët", "Ngjyrat", "Kësulkuqja", "Tre shokët", "Tre gjigandët", etj.

## "My Child" dhe "After Tiller", me debate mbi kinemanë në "Dokufest 2013"

Edicioni XII i Festivalit të Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër "Dokufest 2013" në Prizren ka startuar prej disa netësh në qytetin e Prizrenit. Prodhime të ndryshme kinematografike vijnë para publikut, i cili duket se ka jo pak vëmendje. Po aq sa janë të rëndësishëm filmat që shfaqen, jo pak rëndësi i kushtohet edhe takimeve apo konferencave ku bëhen të ditura detaje të filmave që shfaqen. Edhe dje u mbajt konferenca për shtyp e festivalit "DokuFest", ku morën pjesë regjisorit i filmit "My Child", Can Candan i cili garon sivjet për film-in më të mirë nga Ballkani dhe bashkëregjisorja e filmit "After Tiller", Lana Rose Wilson nga Amerika, si dhe Drejtori Artistik i "DokuFest" Veton Nurkollari. Dokumentari "My child" i regjisorit turk Can Candan sjell rrëfimet e prindërve, fëmijët e të cilëve i përkasin grupit LGBT. "Është një film për një grup të prindërve të cilët kalojnë në një proces të pranimit të fëmijëve të tyre dhe të cilët luftojnë për të drejtat e tyre, dhe gjithë kjo në një shoqëri ku çdo



vit me qindra pjesëtar të komunitetit LGBT vriten", tha regjisorit turk. Më tej ai shtoi se është i mahnitur nga festivali "DokuFest" për faktin se si një festival i filmit dokumentar është aq mirë i integruar me qytetin dhe ka aq shumë rëndësi në jetën kulturore të vendit. Në konferencë ishte e pranishme edhe Lana Rose Wilson, e cila është bashkëregjisore e filmit "After Tiller", film i cili bën pjesë në garën e dokumentarëve për të drejtat e njeriut dhe i cili tregon sa vendim personal është aborti. "Qëllimi është që aborti të shihet nga perspektiva njerëzore jo politike", është shprehur ajo, duke treguar se në

shumë vende ku është shfaqur ky film, publiku e ka pritur ngrohtë, pavarësisht pritjeve të autorëve për protesta apo dhunë. "Wilson po ashtu tha se është e mahnitur me festivalin "DokuFest" dhe me energjinë, që po shihet këto ditë në secilin pjesë të qytetit të Prizrenit. Ndërkaq që po mbrëmë në Hamamin e Prizrenit u mbajt paneli i moderuar nga Adriatik Kelmendi "Objektivat në energjinë e ripërtërishme: Ku qëndron Kosova?", ku u diskutua për strategjinë që ka Kosova për të arritur 25% të konsumit total të energjisë nga energjia e ripërtërishme deri në vitin 2020.

## "I burgosuri i mungesës" promovohet në Rumani

Në Rumani u zhvillua promovimi i librit me poezi "I burgosuri i mungesës" i shkrimtarit shqiptaro-amerikan Gjekë Marinaj. Në këtë eveniment ishte i pranishëm autori i librit, të përkthyer nga përkthyesi dhe shkrimtari Marius Dobresku, i mirënjohur si përkthyesi i veprës pothuaj të Ismail Kadaresë në rumanisht. Gjekë Marinaj, poet, profesor në Dallas (Teksas) dhe banor i SHBA-së qysh nga viti 1991, i pranishëm në këtë ngjarje, dha au-

tografe për miqtë dhe lexuesit e librit të tij në Bukuresht. Në veprimtari morën pjesë studiuesi i letërsisë Luan Topçiu, dramaturgu dhe eseisti i shquar rumun Vlad Zografi (me prejardhje shqiptare nga Korça). Në vlerësimin e tij për poezitë e Gjekë Marinajt, Marius Dobresku tha, ndër të tjera, se poezia e tij sjell një frymë të re në poezinë bashkëkohore shqiptare dhe se është "kontaminuar" nga formimi filozofik i autorit, gjë që i jep poezisë së tij një atmosferë të veçantë.

## Mukaetov dhe Popovski marrin çmimin "Nënë Tereza"

Presidenti i Këshilli Drejtues të "Alkaloid", Zhivko Mukaetov dhe piktori Zhivko Popovski, janë fituesit e sivjetshëm të Çmimit "Nënë Tereza". Këshilli për Dorëzimin e Çmimit Shtetëror "Nënë Tereza" për vitin 2013, ka vlerësuar këta dy qytetarë për arritjet e tyre në interes të shtetit, në sferën e humanitetit dhe të solidaritetit njerëzor. Si bazë për çmimin, është dhe vlerësimi për nxitjen, avancimin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë, si dhe për zhvillimin e bashkëpunimit në mes popujve dhe

pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike, kulturore dhe fetare. Çmimi "Nënë Tereza" ka disa vite që është krijuar dhe më herët janë nderuar të tjerë personalitete, të cilat kanë dhënë një kontribut të vlerësuar në fusha të ndryshme. Çmimi që mban emrin në nder të bamirësesh shqiptare dhe më herët ka pasur shumë vëmendje, pasi ai vlerësohet shumë dhe në qarqet akademike. Edhe në vijim ky çmim do të ketë në vëmendje të tjerë emra që duket se janë në garë për ta merituar atë.

## Ndahet nga jeta shkrimtari Mirko Kovaç

Shkrimtari i njohur Mirko Kovaç u nda nga jeta në moshën 75 vjeçare në Rovinj, Kroaci. Kovaç ka lindur në vitin 1938 në Petroviq të Bileqet, Bosnjë e Hercegovinë. Ka studiuar në Beograd dhe aty ka jetuar deri në fillim të viteve 90-të shekullit të kaluar, kur në fillim të luftës në Kroaci u shpërngul në Rovinj për shkak të kundërshtimit të politikës së Slobodan Milosheviqit. Është autori i librave "Vendekzekutimi", "Tallje me shpirtin", "Por-

ta e zgorit", si dhe skenarët për filmat "Pushtimi në 26 pamje", "Rënia e Italisë" dhe "Rruga e duhanit". Veprat e zgjedhura të Mirko Kovaçit kohë më parë u botuan në 12 vëllime. Ndarja e tij nga jeta në moshën 75 vjeçare ka bërë që letërsia të humbasë një nga emrat më të talentuar dhe të vlerësuar në krijimtarinë letrare. Gjatë aktivitetit të tij si shkrimtar vepra e Kovaç jo pak herë ka qenë në vëmendjen e kritikës vendase dhe asaj botërore.